

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1231 Prot.

Tiranë, më 05.12 2016

VENDIM Nr. 134, datë 22.11.2016

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore"** (i ndryshuar), **VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"** (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13 të datës 22.11.2016, pasi shqyrtoi Raportin e gërmimit të hapur arkeologjik të shpëtimit, në kuadër të **projektit TAP, KM 173+450, fshati Kutalli, Berat**, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e gërmimit të hapur arkeologjik të shpëtimit, në kuadër të **projektit TAP, KM 173+450, fshati Kutalli, Berat**, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të vijojnë punimet e ndërtimit, sipas akt- marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 76, datë 15.07.2016, për projektin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Parë KM 211.8 - KM 145".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI KKA
RUDINA ZOTO